

Dr. Metin IZETI

PARAMETRAT FETARË NË FORMIMIN DHE PËRJETIMIN E IDENTITETIT TË VËRTETË

*“Ekzistenca e unit është e varur prej prodhimit dhe formimit të qëllimeve
Vazhda e jetës është e varur prej ekzistencës së caktuar dhe qëllimit.
Zilja e këtij karvani udhërrëfyes është caku dhe qëllimi”.*

Muhammed Iqbal

*“Kush është kundër historisë, nuk ka mundësi që përnjëherë të vërejë se për cilën
histori është... Edhe historia e filozofisë mund të jetë vetëm një formë ku do t'i
kushtohet rëndësi kujdesit për atë që vjen, nëse kemi dëshmitarë në atë që ka
kaluar”.*

Hans Blumenberg.

Çështja e identitetit është temë mjaftë origjinale, frymëzuese, provokuese dhe motivuese nga aspekti shkencor, ndërsa mbi të gjitha këto, mjaft e dobishme nga aspekti shoqëror në një kohë të tranzicionit qytetar dhe katrahurës marramendëse të globalizmit, kur popujt dhe mjediset e ndryshme të përmbledhura në këtë proces përpiqen të gjejnë identitetin e tyre autentik socio-kulturor. Manifestimet e ndryshme të identitetit të njeriut dhe shoqërisë moderne paraqesin trajtat e ndryshme të qenësisë së tyre shoqërore. Këto trajta të ekzistencës shoqërore e përbëjnë botën reale të njeriut, ashtu si ai e jeton dhe si konceptualisht e reflekton në vetëdijen shoqërore. Pikërisht për këtë, diskutimi rreth identitetit ngërthen përfshirjen e këtij problemi të ekzistencës njerëzore në dy aspekte kryesore, edhe atë: personal, të brendshëm dhe socio-kulturor, të dukshëm.

Feja dhe literatura e shenjtë - në rastin e Islamit, Kur'ani dhe Hadithi- zgjaten dhe kanë ndikim në të dyja aspektet e përfaqësimit të identitetit thelbësor dhe qenësor njerëzor si dhe manifestimit të tij nëpërmjet kulturës dhe traditës së ngritur nga ky thelb fetar në përditshmërinë shoqërore.

Ç'është identiteti personal i brendshëm?

Çështja e personit është problem kryesor i filozofisë ekzistenciale. Unë them “unë” para se të jem i vetëdijshëm për personin tim. “Uni” është i pammë dhe jo i diferencuar dhe nuk parafytyron studimin e individues. Uni është dhunti iskonike, ndërsa individua arritje latitudinale hapësinore. Unë në vete duhet të sendërtoj person dhe ky sendërtim është luftë dhe përpjekje e palodhshme. Vetëdija për personin dhe sendërtimi i personalitetit janë të dhimbshme. Personi paraqet dhimbje dhe shumica pajtohen me humbjen e tij për të mos e ndër këtë dhimbje. Vetë ideja e xhehennemit është e lidhur ngushtë me kultivimin e personit. Individua pa personalitet nuk e njeh ferrin. Personi nuk është identik me individuen, pasi individua është kategori natyraliste dhe biologjike. Individu nuk është vetëm shtaza dhe bima, por edhe perla, gota, lapsi. Personi është kategori shpirtërore e jo natyraliste. Ai i përket përmasës shpirtërore e jo përmasës fizike. Ai krijohet me depërtimin e shpirtit në materie. Nuk ka person pa inkuadrimitin e shpirtit në strukturën trupore të njeriut. Njeriu mund të ketë individualitet hamendës, por të mos ketë personalitet.

Personi nuk është natyrë ashtu si nuk është edhe Zoti. Njëra me tjetrën janë në lidhje të ngushtë, pasi personi është pasqyrim i cilësisë hyjnore në dukshmëri. Personi paraqet ekzistencën e mbivetshmërisë. Personi para së gjithash është kategori e konceptuar dhe është përfaqësim i idesë së krijimit.

Është mjaftë interesante që fjala latine “persona” ka kuptim të “maskës “ dhe është e ndërlidhur me shfaqjen teatrale. Personi para së gjithash është hije. Në hijen, përveç asaj që njeriu zbulohet shumë pak, ai edhe e mbron veten prej ndeshjes me materialen. Për pasojë, shfaqja teatrale nuk është vetëm dëshirë për të luajtur rolin e jetës, por edhe nevojë dhe dëshirë për të mbrojtur veten prej botës që e rrethon, gjegjësisht të qëndrohet me veten në thellësi. Instinkti i teatralës ka dy dimensione. Ai është i lidhur ngushtë me paraqitjen e njeriut në shumësinë sociale. Në këtë shumësi personi dëshiron të marrë pozitë dhe të lozë rolin e tij. Ndërsa nga ana tjetër, “Uni” shndërrohet në një “Unë” tjetër, tjetërsohet dhe e vë maskën.

Një prej problemeve më degraduese nga aspekti i personalizimit ezoterik të njeriut është lozja e rolit kundërshtues me personin e tij dhe krijimi i individues gjegjësisht identitetit të rrejshëm, ose më mirë thënë kundërshtues me krijimin paraiskonik të tij. Feja si realitet etern i krijimit dhe relacionit metahistorik të njeriut, identitetin esencial të tij e sheh në konceptimin dhe formimin real të Unit të tij. Ky Un real atij do t'i mundësonte të njihet me Shkakun dhe Parapëlqyesin e krijimit, gjegjësisht Fuqinë krijuese. Pikërisht për këtë edhe njeriu në formimin dhe përjetimin e identitetit real të tij duhet të orientohet drejt origjinës së tij dhe thelbësisht të njoftohet me Unin e vet. Uni, thotë Ikbali, paraqet njohjen e ekzistencës personale

të njeriut, mbështetjen dhe sigurinë në vetveten, respektin ndaj vetvetes, prezantimin e mundësive dhe aftësive personale dhe assesit nuk ka të bëjë me ndjenjat e egoizmit dhe qibrit. Ikbali, për dallim nga filozofët tjerë muslimanë, si Farabiu, Ibn Sinai, të cilët fillojnë me problemet kosmologjike dhe arrijnë te njeriu, ky fillon prej eksperiencës njerëzore dhe me të mundohet t'i zbërthejë problemet metafizike.

Islami shërbimin më të madh njerëzimit ia ka bërë në vitalizimin e idesë së Unit real dhe përjetimit të identitetit të vërtetë njerëzor. Islami, për dallim nga shumë botëkuptime filozofike idealiste ngjarjet e kësaj bote i sheh si një pjesë të realitetit. Kur'ani kërkon prej njeriut që të forcojë unin e tij dhe të luftojë me çdo lloj të së keqes. Mëkëmbësi i Allahut xh.sh. në faqe të dheut dhe bartësi i emanetit të Allahut nuk mund të qëndrojë duarkryq para shkatërrimit të vetvetes dhe para së keqes.

Përkapjen origjinale të përmasës së Unësisë së pastër të njeriut e shohim edhe në konceptin e njeriut të përsosur (*insan-i kamil*) ose gnostikut (*arif*) në tesavvufin islam. Gnostik është personi që në pasqyrën e unësisë e ka parë veten e tij dhe nëpërmjet pelegrinazhit në urtinë primordiale ka arritur shkallën e ndritjes (*insan nurani*). *Arif*'i është njeri i ndritur i cili me vetënjohjen e mundimshme, me vetëdijesimin, me rrugën kreshnike të dashurisë dhe urtisë, me shkëlqimin e adhurimit të zemrës (*dhikr*) dhe adhurimit të mendjes (*fikr*), bëhet njohës *par excellence* i vetes dhe në bazë të kësaj njohjeje formon identitetin e tij të vërtetë njerëzor.

Hapësira dhe koha më e pafundmë, hijerokozmosi dhe metahistoria e ngritjes së mbretërisë së amshueshme të urtisë primordiale është në brendinë e mikrokozmosit gjegjësisht njeriut. Intima dhe personi njerëzor është qendër, teatër shpirtëror, hapësirë e patrajtë dhe e paformë, ku atributet hyjnore përfaqësojnë pasqyrimet dhe reflektimet më marramendëse. Ndjenja e njeriut për qenien personale si mikrokozmos dhe si vendreflektim i cilësive hyjnore do t'i mundësojë atij të njohë realisht veten dhe identitetin e tij personal ezoterik ta ndërtojë nën kontrollin absolut të Allahut të Lartmadhëruar. Një gjë e tillë personin do ta lidhte në aspekt të normave morale dhe ndjesisë për prezencën e qenësisë hyjnore mbi supe gjegjësisht edhe më afër se damari i qafës.

Nga aspekti i identitetit personal, njeriu ynë i ballafaquar nga njëra anë me globalizimin e shpejtë dhe nga ana tjetër me tretjen e pandërprerë të kualiteteve strukturale të personit të tij, është tejet e rëndësishme që ai ta konceptojë origjinën ezoterike të personit të tij të përbërë prej shpirtit dhe trupit. Shkenca dhe ideologjia e modernitetit me thellimin në shkencat dhe disiplinat statistikore kujdesin e fokusoi në materialen dhe shfaqjen e veprimeve të ezoternes në njeriun, ndërsa e la krejtësisht pas dore përkapjen e vërtetë të shpirtit dhe përmasave të tija. Injorimi i shpirtit solli deri te ajo që njeriu të tëhuajësohet dhe tjetërsohet nga identiteti

original i tij, gjë që nuk është bërë kurrë më parë në historinë njerëzore. Ne gjithmonë kur flasim për orientimet e identitetit tonë fokusohemi në dukshmërinë dhe aspektet socio-antropologjike të tij, dhe harrojmë se në vetë përkufizimin e identitetit të njeriut bën pjesë edhe shpirti si kategori ekzistenciale dhe thelbësore e qenësisë njerëzore. Pikërisht për këtë mendoj se në formimin dhe përjetimin e vërtetë të identitetit tonë duhet t'i kthehemi origjinalitetit të personit të njeriut, përkapjes së intimës shpirtërore dhe rrugës sapiens ekzistenciale për njohjen e vetvetes, e kjo është e mundshme vetëm nëpërmjet të jetësimit të vërtetë të vlerave fetare.

Feja dhe identiteti socio-kulturor...?

Identiteti socio-kulturor i njeriut është bota e tij reale dhe ideale (familja, shoqëria qytetare, kombi, feja dhe filozofia, morali dhe drejtësia, shteti dhe politika) e reflektuar në vetëdijen e tij dhe në jetën e përgjithshme shoqërore të tij. Ky identitet është i nënshtruar ndaj proceseve dhe ndryshimeve të ndjekura me konflikte shoqërore. Identiteti ka qenë shkas për themelimin dhe veprimin e forcave të ndryshme shoqërore dhe lëvizjeve fetare në historinë e njerëzimit.

Problemi i funksionimit të identitetit të vërtetë paraqitet në shoqëritë etno-plurale dhe pluralo-religjioze. Marrëdhëniet e moralit dhe religjionit dukshëm ndikojnë në artikullimin dhe profilimin e identitetit socio-kulturor të individit dhe shoqërisë së caktuar. Interaksioni i religjionit dhe moralit është mjaft e shprehur dhe feja me të vërtetat dhe urdhrat e veta si dhe me praktikën ritualo-adhuroese fuqishëm e determinon botëkuptimin e përgjithshëm mbi botën. Për më tepër, e vërteta e shpalljes hyjnore determinon edhe jetën edhe vdekjen, imanenten dhe transcendenten, duke shfaqur fotografi të tërësishme të strukturës metafizike të jetës dhe botës, pozitës dhe rolit të Qenies Absolute në të, gjegjësisht Krijuesit të Përgjithshëm, Allahut xh. sh.

Nuk ka aspak dyshim se identiteti socio-kulturor si dhe ai personal i yni është thellë i rrënjësuar në sferat e fshehta të strukturës metafizike të fesë. Shpallja hyjnore dhe transcendentimi njerëzor si udhë e sendërtimit të përmbajtjes dhe kuptimit të shpalljes dhe afrimit deri te Zoti xh. sh. janë parametrat themelorë me të cilët përcaktohet struktura dhe karakteri i metafizikës së çdo feje të shpallur. Struktura themelore metafizike transponohet në realitetin shoqëror (zakonor), kulturor dhe politik si veprimtari e përgjithshme materiale dhe kuptimore vepruese. Në përgjithshmërinë e tij, gjegjësisht në kulturën dhe qytetërimin, kristalizohet “kahja kulturore”, kahja menduese, konceptuese rreth botës dhe njeriut - vetvetes brenda saj dhe misionit në të. Islami si fe e shpallur, në këtë mënyrë e krijoi bazën teologjiko-metafizike për konstituimin e identitetit socio-kulturor.

Të gjithë popujt që e kanë pranuar Islamin në formimin e identitetit të tyre, kush më tepër e kush më pak, dukshëm janë ndikuar prej elementit fetar, ndërsa reflektimi i besimit të tyre në përditshmëri nëpërmjet ibadeteve është bërë pjesë përbërëse e kulturës dhe qytetërimit të tyre. Identiteti i cili i mundëson personit që ta përjetojë veten si person të pavarur, të vetëdijshëm për pozitën e tij shpirtërore dhe shoqërore, të njeriu ynë është formësuar nëpërmjet fesë Islame, gjegjësisht Islami është bërë pjesë e pandarë e identitetit tonë real (merret vesh te pjesa e popullatës që e kanë pranuar Islamin). Marrëdhëniet e njeriut tonë me vetveten dhe me mesin që e rrethon, herë pas here edhe më gjerë, janë rregulluar në bazë të parimeve Islame të cilat me kalimin e kohës në disa përmasa shoqërore kanë marrë edhe trajtën e zakoneve dhe dokeve.

Sot njeriu ynë, por edhe njeriu në përgjithësi në faqen e dheut, është i ballafaquar me krizë të identitetit. Kjo krizë është rezultat i proceseve marramendëse botërore të zhvilluara në kundërshtim me shpirtin real njerëzor. Transponimi i shpirtit joreal njerëzor në shoqërinë njerëzore rezultoi me katrahurë dhe pidentitetshmëri të kobshme.

Problemi i krizës së identitetit është më se e vërtetë se e hasim te pjesa e madhe e të rinjve të cilët janë rritur dhe edukuar me absolutizmin e mekanikës letargjike të modernitetit. Në periudhën e rinisë personi përpiqet që të integrojë identifikimet e ndryshme të cilat i imponohen nëpërmjet medimeve të ndryshme. Burimi i identitetit të tij është i përmbajtur në sintezat suksesive të cilat i krijon egoja nëpërmjet zhvillimit, duke integruar dalëngadalë trajtat praktike të individuumit të reklamuar, e motivuar gjithnjë nga potencialet pasionike. Në këtë periudhë të formimit të identitetit, kur personi shumë lehtë mund të marrë tatëpjetën, religjioni luan rol tejet të rëndësishëm në formimin dhe përjetimin e brendisë reale të identitetit personal dhe socio-kulturor.

E vetmja zgjidhje për krizën e identitetit është diagnostifikimi i gabimit të bërë, e që sipas meje është në braktisjen e shpirtit të uritur dhe ngopjen e tepërt të barkut me ushqime të shpejta "fast food", në ndërprerjen e koloritësisë kulturore dhe largimin e të vërtetave të shpalljes prej jetës shoqërore, e pas kësaj evitimi i saj me çiltërsinë e Librit të Allahut dhe pragmatizmin e traditës profetike.